



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 134, Datë 25.06.2018

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“EDIANI” SH.P.K, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “SHËNGJON 1” ME FUQI TE INSTALUAR
651 KW, “SHËNGJON 2” ME FUQI TE INSTALUAR 356 KW DHE “SHËNGJON 3”
ME FUQI TE INSTALUAR 341 KW, ME FUQI TOTALE 1348 KW.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”; nenit 10 pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funkionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EDIANI” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC – et “Shëngjon 1”, “Shëngjon 2”, dhe “Shëngjon 3”

Konstatoi se:

- Shoqëria “EDIANI” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 421 Prot, datë 29.05.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC – et “Shëngjon 1”, “Shëngjon 2”, dhe “Shëngjon 3”.
- Aplikimi i shoqërisë “EDIANI” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5 gërmat, “a”, “c”), plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3 gërma “c”, (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit),
- Nenin 9, pika 4.1.5, gërma “b” (Leja për përdorimin e ujit),
- Depozitimin në ERE të kontratës shtesë të Koncesionit, nr. 886 Rep dhe nr. 246 Kol, datë 11.09.2016, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI) dhe Shoqërisë “Ediani” sh.p.k, për ndërtimin e HEC-eve: “Shengjon 1”; “Shengjon 2” dhe “Shengjon 3”, të nënshkruar nga të dy palët.
- Detaje mbi zonën e pronësisë dhe përputhshmërinë e saj me sipërfaqen e HEC-it.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

- 1.** Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EDIANI” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “SHËNGJON 1” me fuqi të instaluar 651 kW, “SHËNGJON 2” me fuqi të instaluar 356 kW dhe “SHËNGJON 3” me fuqi të instaluar 341 kW, me fuqi totale të instaluar 1348 Kw.
- 2.** Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.